



REPUBLIKA E SHqipëRISE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 130, dt. 03.07.2015

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03.07.2015, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture të kategorisë së I-rë, të “Kompleksi i banesave të familjes Zhapa” si dhe zonën e mbrojtur të këtij kompleksi në Labovë të Vogël (Zhapës), Gjirokastrë.
  2. Miratimin e propozimit për shpallje monument kulture e kategorisë së I-rë të banesës së Vangjush Mio, Lagjja 3, Rruga “Spiro Ballkameni”, Korçë.
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI